

## DEKLARATË

### Pas përmbylljes së tekstit ligjor të Reformës Zgjedhore, koha për t'i kushtuar vëmendje gjendjes institucionale në vend

Pas konkretizimit të vullnetit të përbashkët politik, në një tekst ligjor amendimesh, në zbatim të Marrëveshjes Politike të 5 qershorit 2020 dhe depozitimit dy ditë më parë të tij pranë Komisionit të Ligjeve, KRIIK, pas një angazhimi monitorues më shumë se 16 mujor publikon sot përkrah kësaj Deklarate, edhe [Raportin “Sjellja ligjore dhe institucionale e institucioneve dhe aktorëve të përfshirë në procesin zgjedhor të 30 qershorit 2019”](#).

Ky Dokument vjen në frymën e një auditimi post zgjedhor të ecurisë procedurale dhe sjelljes institucionale, të cilin KRIIK e ka advokuar si një instrument të rëndësishëm në garantimin e integritetit zgjedhor.

Pas ndjekjes së ecurisë politiko-institucionale që i parapriu, shoqëroi dhe pas-solli procesi i 30 Qershorit 2019, në perspektivën e KRIIK, kjo përvojë garimi elektoral, efektivisht pa garues, u ndoq si një përvojë laboratorike në analizimin e kapacitetit ligjor dhe institucional për mbarëvajtjen e proceseve zgjedhore me integritet, për aq sa u bë e mundur.

Përvoja e 30 Qershori 2019 shënoi një nga precedentët më të ulët të përvojës zgjedhore të vendit tonë dhe njëkohësisht *përbëri një konkluzion të tërë problematikës të deritanishme në projektin demokratik të vendit.*

Për shkak se procesi elektoral ishte një garim pa presionin e rezultatit zgjedhor, sfida e vetme ishte mbarëvajtja procedurale. Kësisoj, KRIIK monitoroi përtej metodologjisë së zakonshme të një misioni vëzhgimi, tërë të ashtuquajturin “shirit të kuq” procedural që ndoqi ecurinë e procesit.

Në konkluzion të së tërës dhe referuar gjetjeve në Dokumentin bashkëshoqërues, përvoja në fjalë definoi **çdo rrethanë të realitetit ligjor-institucional si të nënshtruar ndaj vullneteve të establishmentit politik.**

Kjo përvojë **dëshmoi prej tërë mekanizmit shtetëror, një sjellje institucionale dhe një zbatim të ligjit në funksion të dinamikave bi-partizane.**

Vlerësohet se 30 Qershori 2019 zhbëri tërë investimin dhe angazhimin e aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm, civilë dhe politikë, për një realitet institucional dhe ligjor që mund të ndërmarrë procese të ligjshme, aq më shumë me integritet.

Dakordësia politike e 5 Qershorit 2020 ishte një arritje, por jo në raport me pritshmëritë e një demokracie 30 vjeçare.

Ajo është një hap pozitiv në kontekstin e krizave të vijueshme politike dhe rrezikut të dështimit të reformave madhore ku gjendet vendi, por nuk duhet të kurrësesi të stopohet këtu.

Address:

Rr. "Ymer Kurti",  
Nd.4, H.2, Ap.3,  
Nj.Adm.5,  
Tirana

Mailing address:

P.O.Box. 2396  
Tirana, 1001,  
Albania

Me anë të këtij Dokumenti, KRIIK, me përvojën e angazhimit në monitorimin e zgjedhjeve dhe reformimit të kuadrit ligjor, shfrytëzon pikërisht këtë moment suksesi të parë të dakordësisë politike, **për të sjellë në vëmendje të aktorëve përgjegjës një problematikë po aq madhore, gjendjen institucionale në vend.**

Në konsideratën e KRIIK, kjo **gjendje e kapacitetit ligjor-institucional paraqitet si përgjegjësi direkte e tërë establishmentit politik** dhe rëndon në jetët e tërë qytetarëve shqiptarë.

Si e tillë, nevojitet një zgjatim i kësaj **dakordësie politike për një reformim madhor dhe integral të mekanizmit**, si një sfidë më vetë, përtej zgjedhjeve që priten.

Kjo reformë, asesi, nuk mund të mendohet si e përciptë dhe dritëshkurtër, por nevojitet të jetë një proces afatgjatë, i mirëmenduar dhe radikal.

Në ekspertizën e KRIIK, **kjo reformë duhet të ndërmarrë masa radikale** që nga rritja domosdoshmërisht e transparencës së institucioneve, e deri tek ridimensionimi i administratës zgjedhore.

Ky proces ridimensionimi, nevojitet të sillet me objekt jo vetëm ndërtimin e një administratë jo-politike, por të shkohet deri tek realiteti **ku “barra e provës” në drejtësinë zgjedhore t’i kalojë vetë kësaj administrate.**

Funksionari zgjedhor apo burokrati i përfshirë në çështje zgjedhore, si përfaqësues apo nëpunës i institucioneve përkatëse, nevojitet **të jetë garanti dhe të marrë përgjegjësitë përkatëse në sigurimin e integritetit** në proceset zgjedhore.

Në përfundim, sillet në kujtesë se në funksion të amendimeve që priten të miratohen, shumë shpejt do të kryhet edhe emërimi i anëtarëve të tre strukturave të reja zgjedhore në zhbërje të trupës së KQZ-së aktuale.

Në përzgjedhjen e kandidaturave nxiten të gjithë aktorët politikë e vendimmarrës, të kenë parasysh sjelljen e kritikueshme në vijimësi të anëtarësisë së trupave të KQZ-së, madje edhe përvojat e praktikat e deritanishme të ligjzbatimit dhe integritetit institucional të sjellë në vëmendje të opinionit publik edhe nëpërmjet këtij Raporti Monitorimi 16 mujor, në mënyrë **që të ndërtohet një proces garimi dhe filtrimi i barabartë, me standarde rigorozë vlerësimi në raport me integritetin profesional dhe atë personal në raport me ligjin dhe institucionet.**

***Tiranë, më 3 Korrik 2020!***

Address:

Rr. "Ymer Kurti",  
Nd.4, H.2, Ap.3,  
Nj.Adm.5,  
Tirana

Mailing address:

P.O.Box. 2396  
Tirana, 1001,  
Albania